



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETARËVE**  
**TË DISA KZAZ-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zëvendëskryetar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me

**OBJEKT:** Për emërimin kryesisht të disa sekretarëve të KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 28, pika 1, neni 29, pika 5, neni 30, neni 31, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 141, datë 09.04.2019, plotësoi vakancat në KZAZ-të, duke emëruar kryesisht anëtar në KZAZ me numër tek dhe sekretar në KZAZ me numër çift nga lista e shtetasve të miratuar me vendimin e KQZ nr. 140, datë 09.04.2019, të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë dhe sekretarë të KZAZ.



**Nr. 173 i Vendimit**

**Data 16.04.2019 e Vendimit Ora 12<sup>00</sup>**

Për emërimin kryesisht të sekretarëve të disa KZAZ-ve  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Për KZAZ nr. 22 dhe nr. 24 (komisione të zonave të administrimit zgjedhor në Bashkinë Durrës), KZAZ nr. 60 (Bashkia Roskovec), KZAZ 80 (Bashkia Dropull), KZAZ nr. 86 (Bashkia Himarë), vakancat e konstatuara në pozicionin e sekretarit të KZAZ-së nuk u plotësuan pasi shtetasit në listën e miratuar nga KQZ, me vendbanim në këto zona zgjedhore, nuk ishin me arsim juridik.

Në përgjigje të thirrjes publike në mbledhjen e datës 9.04.2019, kanë paraqitur kërkesë të shoqëruar me dokumentacion, për plotësim të vakancave në pozicionin e sekretarit të KZAZ-ve sipërcituar shtetasit:

1. Elga Nikolla Gogo, banore e Bashkisë Durrës;
2. Teodor Iljaz Labi, banor i Bashkisë Durrës;
3. Daniela Petrit Rexho, banore e Bashkisë Durrës (Njësia Administrative Sukth);
4. Evisa Sami Gishto (Mustafaj), banore e Bashkisë Roskovec;
5. Pirro Thanas Boboli, banor i Bashkisë Dropull;
6. Nurjet Jani Mici, banor i Bashkisë Himarë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të të dhënave, rezulton se për plotësim të vakancave të konstatuara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor:

Shtetasit Elga Nikolla Gogo, Daniela Petrit Rexho dhe Teodor Iljaz Labi, për emërim kryesisht për plotësim të vakancës në pozicionin e sekretarit të KZAZ-së 22 dhe 24;

Shtetasja Evisa Sami Gishto, për emërim kryesisht për plotësim të vakancës në pozicionin e sekretarit të KZAZ-së 60, Bashkia Roskovec;

Shtetasi Pirro Thanas Boboli, për emërim kryesisht për plotësim të vakancës në pozicionin e sekretarit të KZAZ-së 80, Bashkia Dropull;

Shtetasi Nurjet Jani Mici, për emërim kryesisht për plotësim të vakancës në pozicionin e sekretarit të KZAZ-së 86, Bashkia Himarë.



**Nr. 173 i Vendimit      Data 16.04.2019 e Vendimit      Ora 12<sup>00</sup>**

Për emërimin kryesisht të sekretarëve të disa KZAZ-ve  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Plotësimi i vakancës në KZAZ nr. 22, 24, 60, 80, 86, u krye sipas Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Bazuar në nenin 23, pika 1 gërma "a", nenin 28, pika 1, nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ, sipas lidhjes Nr.1 bashkëlidhur.
2. Të emërojë kryesisht në detyrën e sekretarit të KZAZ nr. 22, 24, 60, 80, 86, shtetasit sipas lidhjes Nr.2 bashkëlidhur.
3. Mbledhja e parë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor nr. 22, 24, 60, 70, 80, 86, të zhvillohet ditën e enjte, datë 18 Prill 2019, ora 10.00 në Selitë e KZAZ-ve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 173 i Vendimit      Data 16.04.2019 e Vendimit      Ora 12<sup>00</sup>**

Për emërimin kryesisht të sekretarëve të disa KZAZ-ve  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019